

Dërgimi i punëtorëve

Dërgimi i punëtorëve dhe punëmarrësve në kuadër të ofrimit të shërbimeve

Kuadri ligjor për dërgimin e punëtorëve në kuadër të ofrimit të shërbimeve në BE dhe në legjislacionin kombëtar përbëhet nga disa normativa të niveleve të ndryshme. *Direktiva 96/71/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 Dhjetorit 1996 për dërgimin e punëtorëve në kuadër të ofrimit të shërbimeve*, përbën legjislacionin dytësor bazë të BE, që rregullon dërgimin e punëtorëve me qëllim ofrimit të shërbimeve ndërkombëtare nga një ndërmarrje e vendosur në një Shtet Anëtar në territorin e një Shteti Anëtar tjetër. Direktiva rregullon përcaktimin e kriterëve dhe kushteve të punësimit për punëtorët e dërguar.

Për të siguruar zbatimin e Direktivës 96/71/KE u miratua *Direktiva 2014/67/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 15 Majit 2014 që amendon Rregulloren (BE) Nr.1024/2012 mbi bashkëpunimin administrative përmes Sistemit të Informacionit të Tregut të Brendshëm*. Direktiva përcakton dispozita, masa dhe mekanizma kontrolli të nevojshëm për të garantuar zbatimin, më të mirë në praktikë të Direktivës 96/71/KE. Nëpërmjet kësaj direktive, synohet të garantohet mbrojtja e të drejtave të punëtorëve të dërguar për ofrimin e shërbimeve ndërkufitare dhe në veçanti zbatimi i kriterëve dhe kushteve të punësimit që zbatohen në shtetin anëtar ku do të ofrohet shërbimi.

Direktiva (BE) 2018/957 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 28 Qershorit 2018 amendon Direktivën 96/71/KE për dërgimin e punëtorëve në kuadër të ofrimit të shërbimeve. Direktiva u jep të drejta shtesë punëtorëve të dërguar si dhe mbrojtje të plotë për të drejtat e punës, përfshirë dhe rastin e dërgimit jo sipas përcaktimeve të direktivës.

Direktiva (BE) 2020/1057 që përcakton rregulla specifike në lidhje me Direktivën 96/71/KE dhe Direktivën 2014/67/BE për postimin e drejtuesve në sektorin e transportit rrugor dhe që ndryshon Direktivën 2006/22/KE në lidhje me kërkesat e zbatimit dhe Rregulloren (BE) Nr 1024/2012

Në rastin e dërgimit të punëtorëve në kuadër të ofrimit të shërbimeve, përveç dispozitave të direktivave të sipërpërmendura, duhet të jenë në vëmendje dhe rregullat e përcaktuara në *Rregulloren (KE) Nr.883/2004 mbi koordinimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore dhe Rregulloren (KE) Nr. 987/2009 e cila përcakton procedurat për zbatimin e Rregulloreve (KE) Nr.883/2004*, lidhur me garantimin e të drejtës së individëve për t'u siguruar nën legjislacionin njërit Shtet Anëtar, dhe në këtë rast në legjislacionin e Shtetit dërgues.

Në nivel kombëtar, legjislacioni kryesor për dërgimin e punëtorëve në kuadër të ofrimit të shërbimeve është:

- Kodi i Punës
- Ligji për të huajt
- Ligji për transportin rrugor

Të rëndësishme po ashtu janë dhe marrëveshjet dypalëshe për sigurimet shoqërore që Republika e Shqipërisë ka lidhur me Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian.

Legjislacioni shqiptar, përcakton dërgimin e punëmarrësve nga një ndërmarrje e huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë në tre raste. Kur një ndërmarrje e huaj:

- a) i dërgon punëmarrësit në Shqipëri, për një periudhë jo më shumë se 12 muaj, për llogari dhe nën drejtimin e saj, në bazë të një kontrate të lidhur midis ndërmarrjes dërguese dhe ndërmarrjes së regjistruar në organet tatimore shqiptare, për të cilën synohen punët ose shërbimet, me kusht që, gjatë periudhës së dërgimit, të ketë një marrëdhënie punësimi midis ndërmarrjes dërguese dhe punëmarrësit; ose
- b) i dërgon punëmarrësit në një ndërmarrje, pjesë të saj, në territorin e Shqipërisë, me kusht që, gjatë periudhës së dërgimit, të ketë një marrëdhënie punësimi midis ndërmarrjes që kryen dërgimin dhe punëmarrësit; ose
- c) duke qenë agjenci për punë të përkohshme, rekruton një punëmarrës për një ndërmarrje pritëse, që është krijuar ose vepron në territorin e Shqipërisë, me kusht që, gjatë periudhës së dërgimit, të ketë një marrëdhënie punësimi midis agjencisë së punësimit të përkohshëm ose agjencisë së punësimit dhe punëmarrësit (neni 3/1, pika 1 e Kodit të Punës)

Shtetasit e huaj nga vende anëtare të BE apo zonës Shenges, si dhe anëtarë të familjeve të tyre që nuk kanë shtetësinë e këtyre vendeve, përjashtohen nga detyrimi për t'u pajisur me Miratim për Punësim nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe marrin vetëm leje e cila autorizon qëndrimin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë gjatë ofrimit të shërbimit (neni 80, pika 1, ligji për të huajt). Sipas ligjit për të huajt, ata vetëm duhet të bëjnë një deklaratë për punësimin e tyre në e-albania.

Shtetasit e huaj nga vende jo anëtare të Bashkimit Evropian apo zonës Shengen, si dhe që nuk janë shtetas të vendeve të cilat përjashtohen nga detyrimi për t'u pajisur me Miratim për Punësim sipas pikës 1 të nenit 80 të ligjit për të huajt, duhet të pajisen me leje qëndrimi ose leje unike në Republikën e Shqipërisë para fillimit të ofrimit të shërbimit të përkohshëm në territorin e RSH (neni 3, neni 81, neni 70 dhe neni 59 i ligjit për të huajt).

Deri tani legjislacioni kombëtar gëzon një përafrim të pjesshëm me Acquis e BE për dërgimin e punëtorëve dhe puna për arritjen e përafrimit të plotë të tij, është në progres të vazhdueshëm me ambicien për arritjen e përafrimit të plotë brenda vitit 2027.